



YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI RINOR PËR DREJTAT E NJERIUT



Raport monitorues 14-të

mbi punën e legjislativit të komunës së
Lipjanit

Dhjetor 2016

Përmbajtja:

- Hyrje,
- Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendi të Komunës së Lipjanit,
- Zgjedhjet lokale në Lipjan
- Përmbledhje ekzekutive,
- Dinamika e punës së Kuvendit,
- NOTIMI,
- TRENDI I DISKUTIMEVE,
- ÇËSHTJET E INICIUARA,
- PYETJET E PARLAMENTARE,

Adresa: Rr."Dr. Avdi Avdiu" 14000 Lipjan

Tel.+377 (0) 44 786 414 ;

e-mail: info.yahr@gmail.com

ueb faqja: <http://www.ngoyahr.weebly.com>

<http://www.yahr-monitorimi.weebly.com>

<https://www.facebook.com/YAHR.Kosovo/>

"Ky projekt u financua përmes grantit të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International"



Hyrje

Organizata Joqeveritare YAHR- do të vazhdojë me monitorimin e aktiviteteve të legjislativit dhe të ekzekutivit të Komunës së Lipjanit ,gjatë periudhës katër vjeçare 2013/2017 dhe do të dal me raporte monitoruese- vlerësuese për çdo gjashtë muaj.

Youth Association for Human Rights /YAHR që nga vitit 2009 është duke bërë monitorimin pro aktiv të punës së kuvendit të Komunës së Lipjanit. Në monitorimin e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për periudhën gjashtë mujore, nëpërmes këtij raporti YAHR provon të kontribuoj në ofrimin e informacioneve të strukturuar të cilat do të jenë në shfrytëzim, para së gjithash për qytetarin e Komunës së Lipjanit, shoqërinë civile, mediat, si dhe vetë institucionin e monitoruar, Kuvendin e Komunës së Lipjanit. Në këtë drejtim, në formë të renditur nëpërmes këtij raporti ofrojmë të dhëna të cilat pasqyrojnë disa aspekte të punës së Kuvendit. YAHR nëpërmjet monitorimit pro aktiv ka arritur t'i siguroj këto informacione, të cilat do të mund të zhvilloheshin edhe më tej, në rast të një bashkëpunimi më cilësor nga ana e institucioneve, apo edhe në rast të organizimit dhe funksionimit të tyre më të mirëfilltë. Nëpërmes aktiviteteve monitoruese YAHR është përfshirë në këto drejtime si puna në seanca plenare dhe puna në Komitetet.

Në hartimin e këtij raporti të katërmbëdhjetë monitorues për punën e legjislativit të Kuvendit komunal të Lipjanit, YAHR është mbështetur në shumë burime të informacionit: monitorimi i seancave të Kuvendeve Komunale, Komiteteve për Politikë dhe Financa, analizimit të dokumenteve të ndryshme si procesverbale dhe rendet e ditës, analizimi i raporteve të medieve të shkruara dhe elektronike, debatet si dhe diskutimet e organizuara nga shoqëria civile.

Bekim Krasniqi

Drejtor ekzekutiv i YAHR-it

Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendi të Komunës së Lipjanit

YAHR në tentativë për të adresuar interesat dhe brengat të qytetarëve në mënyrë të paanshme dhe apartiake u ofron qytetarëve informata në mënyrë të vazhdueshme. Synimi i monitorimit të punës së zyrtarëve të zgjedhur është ndërtimi i një shoqërie të qëndrueshme demokratike.

Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve komunal janë:

- Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendore;
- Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- Që zyrtarëve të zgjedhur t’iu ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria civile;
- Që të informohen qytetarët se si zyrtarët e zgjedhur trajtojnë brengat e tyre si bazë për çfarëdo veprimi qytetar drejt zgjidhjes së atyre brengave.

Zgjedhjet lokale në Lipjan


Kuvendi Komunal i Lipjanit ka 31 ulëse. Në mandatin e parë qeverisës, shumica e vendeve në KK i ka takuar LDK-së. Dy vite më vonë, zgjedhjet e dyta lokale nxorën PDK-në si partinë më të madhe në këtë komunë. PDK fitoi 14 ulëse dhe së bashku me një përfaqësues të AAK qeverisën me komunën për pesë vite. Edhe në mandatin e tretë PDK kishte shumicën e ulëseve, edhe pse kishte një përfaqësues më pak. Edhe numri I votave për këtë subjekt politik kishte rënë në krahasim me zgjedhjet e vitit 2002. Humbjen më të madhe të votave në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007 e pësoi LDK, votat e së cilës u përgjysmuan. Në Pesë legjislaturat e gjertanishme vetëm tri parti politike kanë arritur që të përfaqësohen vazhdimisht. Në zgjedhjet e 2013-tës, prapë udhëheqë PDK-ja si parti më e madhe në komunë me 10 deputet. Kemi një numër të njëjtë të LDK-së sikurse në zgjedhjet e vitit 2009 në 9 deputet. Kemi një ulje të AKR-së dhe një ngritje të AAK-së për shkak të koalicionit AAK-LDD-IQL me pesë deputet , po ashtu PSD-ja e kemi me një deputet. Risi në këtë legjislaturë është hyrja e VV-së dhe G.I.SRPSKA me një deputet.

Në legjislaturën e dytë (2002-2007) kanë qenë të përfaqësuar edhe dy serbë nga dy parti të ndryshme politike. Kurse në legjislaturën e (2007-2009) edhe komuniteti ashkali kishte siguruar një vend, kurse të tanishmen (2009-2013) nuk ka pasur asnjë deputet nga komunitetet pakicë.

Tabela 1.: Struktura politike e Kuvendeve të Komunës së Lipjanit 2000/2013

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007		Zgjedhjet 2009		Zgjedhjet 2013	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	8317	13	10283	14	8925	13	7,926	12	8,601	10
LDK	10718	16	9923	13	4404	7	6,474	9	7,434	9
AAK	1109	2	840	1	929	1	1,036	2	-	-
LDD	-	-	-	-	1677	3	1,138	2	-	-
AKR	-	-	-	-	3007	5	2,652	4	2,047	2
ORA	-	-	-	-	746	1	477	1	-	-
PDAK	-	-	-	-	563	1	-	-	-	-
DCC	-	-	523	1	-	-	-	-	-	-
“Povratok”	-	-	391	1	-	-	-	-	-	-
PSD	-	-	-	-	-	-	847	1	643	1
VV	-	-	-	-	-	-	-	-	1,494	2
G.I.SRPSKA	-	-	-	-	-	-	-	-	540	1
AAK-LDD-IQL	-	-	-	-	-	-	-	-	4,037	5

Grafiku 1. Paraqitja e numrit te deputeteve sipas subjekteve politike te përfaqësuar ne Kuvendin e Lipjanit



Përmbledhje ekzekutive

Youth Association for Human Rights (YAHR) publikon raportin e monitorimit “Qeverisja Lokale në Lipjan” bazuar në monitorimin e punës së Kuvendit komunal të Komunës së Lipjan gjatë periudhës Korrik - Dhjetor 2016. Monitorimi është fokusuar në Asamblenë Komunale dhe organet tjera të këtij Kuvendit.

Në bazë të punës sonë monitoruese të drejtpërdrejtë dhe në bazë të vlerësimeve me anë të fletë notimit kemi konstatuar këto fakte:

- ✓ Gjatë periudhës raportuese Korrik - Dhjetor 2016, kuvendi komunal i Lipjanit ka pasur një dinamikë të mirë të aktiviteteve. Ku gjatë kësaj periudhe kemi 41 vendime të miratuara ose 70.68 % dhe krahasuar me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar kemi një rritje prej 100 %, pastaj kemi 10 raporte apo njoftime të ndryshme të shqyrtuara me 17.24 % dhe 7 rregullore ose plane komunale të miratuara me 12.06 % nga totali i përgjithshëm të aktiviteteve.
- ✓ Në vitin 2016 vërehet një tendencë nga ana e ekzekutivit të Komunës së Lipjanit që ti lihet apo të ngarkohet Kuvendi komunal me më shumë përgjegjësi në marrjen e vendimeve të servuara të gatshme nga ana e ekzekutivit. Ku kemi një rritje të aprovimit të vendimeve krahasuar me vitin e kaluar, për shembull në vitin 2015 i kemi pasur 24 vendime të miratuara nga e Kuvendit komunal, ndërsa gjatë vitit 2016 i kemi një rritje prej 70 % nga 24 në 41 vendime të miratuara.
- ✓ Top treshja me aktive nga ana e deputetëve të kësaj legjislature për periudhën Korrik - Dhjetor 2016 është: **RAMIZ QIRIQI PSD 91 pikë, FLORENT HOXHA PDK 78 pikë dhe LULZIM RRUSTEMI PDK 66 pikë.**
- ✓ Top tresha më pasive në Kuvendin Komunale për periudhën Korrik - Dhjetor 2016 përbëhet nga deputetet: **VALBONA SHILLOVA PDK 0 pikë, NAIM JAHIRI LDK 0 pikë dhe ARTON RETKOCERI LDK -1 pikë.**
- ✓ Është interesante se gjatë kësaj periudhe raportuese kemi një dinamikë të mirë të ngritjes së shqetësimeve të qytetareve nga ana e deputeteve. Ku kemi 45 çështje të ngritura të problemeve të ndryshme që preokupohen qytetarët e Komunës së Lipjanit dhe krahasuar me vitin e kaluar kemi një rritje prej 200 %. Ndërsa, nga Subjektet politike me aktive është Subjekti i PDK-së i cili gjatë kësaj periudhe i ka ngritur 21 çështje të qytetarëve ose 46.67 % prej totali të përgjithshëm, pastaj është interesant krahasim me vitin e kaluar kemi një angazhim shumë më aktiv të AAK-LDD-IQL me 7 çështje të ngritura ose 15.56 % dhe po ashtu PSD 1 me 7 çështje të ngritura ose 15.56 % , pastaj vazhdohet VV dhe AKR-në me nga 3 çështje te ngritura , G.I.SRPSKA me 2 ose me 4.44 % dhe LDK me PD me nga 1 çështje të ngritur me 2.22 %.



- ✓ Sa i për ketë pyetje parlamentare të drejtuar mbi punën e ekzekutivit kemi Subjektin politik të PSD më aktiv, ku kemi 4 pyetje, pastaj edhe AAK-LDD-IQL me 2 pyetje.
- ✓ Komuna e Lipjanit vazhdon me shkeljen e Ligjit për Kufijtë Administrativë të Komunave Nr. 03/L-041 të datës 20 shkurt 2008, me anë të Statutit Komunal (Nr. .110-623 i datës 26.09.2008). Ku në bazë të këtij ligji, Komuna e Lipjanit i ka 59 vendbanime dhe fshatra, ndërsa në Statutin Komunal në kapitullin II, ku ka të bëjë me vendbanimet e komunës, gjejmë në nenin 13. rreth vendbanimet dhe fshatrat, figurojnë 70 vendbanime dhe fshatra, që do të thotë në bazë të ligjit të lartë përmendur Komuna e Lipjanit i ka 11 fshatra më pak se sa me statutin komunal.
- ✓ Vazhdohet me mos transparencë nga ana e Kryesueses së Kuvendit Komunal, me injorimin e dërgimit të materialeve të seancave të Kuvendit ndaj organizatave të shoqërisë civile dhe bëjnë seleksionimin se cilat janë të përshtatshme për të bashkëpunuar me ta.



Rekomandimet:

- ✓ Të tregohet respekt nga ana e deputeteve për zgjedhësit e tyre dhe se nuk kanë nevojë që të nxitojnë për të përfunduar sa më shpejtë mbledhjet, se punën e tyre paguhen me mëditje
- ✓ Ofrimin e përgjigjeve nga ana e ekzekutivit ndaj pyetjeve të parashtruar nga ana e deputeteve komunal,
- ✓ Harmonizimi i Statutit Komunal me (Nr. .110-623 i datës 26.09.2008) dhe ligjet aktuale në fuqi



të Republikës së Kosovës, gjegjësisht me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave Nr. 03/L-041 të datës 20 shkurt 2008.

- ✓ Një opozitë me e zëshme për artikullimin e interesave të qytetareve karshi ekzekutivit të Komunës së Lipjanit,
- ✓ Dërgimin e materiale të Kuvendit për organizatat monitoruese,
- ✓ Delegatet e Kuvendi i Komunës së Lipjanit duhen të jenë më aktivë dhe më efikas , e sidomos nëpër komitete.


Dinamika e punës së Kuvendit

Në këtë vit 2016 deri me tani janë mbajtur nëntë seanca plenare të rregullta dhe një e jashtëzakonshëm, me qëllim të ri-destinimit të mjeteve buxhetor për vitin 2016. Ndërsa, janë mbajtur vetëm nëntë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe financa. Nëse bëjmë një krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar është një gjendje e njëjtë.

Tabela krahasuese 2: Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit gjatë 2015 dhe 2016

Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit					
Raporte të shqyrtuara		Rregullore dhe plane komunale të miratuara		Vendime komunale të miratuara	
2015	2016	2015	2016	2015	2016
5	10	5	7	24	41

Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit



Lista e raporteve të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2016:

- *Njoftim me gjendjen e sigurisë në Komunën e Lipjanit për vitin 2015*
- *Informatë për punën e KKS-së për vitin 2015.*
- *Raporti i punës së Kryetarit dhe i Drejtorive Komunale për vitin 2015*
- *Raporti i buxhetit dhe shpenzimeve bazë të burimit të mjeteve kategorive ekonomike dhe programeve për vitin 2015 për Komunën e Lipjanit.*
- *Raport tre mujor i shpenzimeve të buxhetit, realizimi i investimeve kapitale dhe të hyrat për periudhën Janar-mars 2016,*
- *Raporti 6 mujor i shpenzimeve dhe të hyrave për vitin 2016,*
- *Informatë mbi punën e Komiteteve funksionale,*
- *Raporti i punës së Kryetarit të Komunës dhe drejtorive komunale për periudhën gjashtëmujore Korrik - Dhjetor 2016*
- *Raporti i auditorit të përgjithshëm për pasqyrat vjetore financiare për vitin 2015*
- *Informatë nga DKA mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2016/2017,*
- *Raport i shpenzimeve të buxhetit, realizimi i të hyrave dhe realizimi i investimeve kapitale për nëntë mujorin 2016.*
- *Informatë mbi planifikimin e të mbjellave vjeshtore,*
- *Informatë mbi procesin e legalizimit të objekteve pa leje,*
- *Informatë mbi gjendjen e furnizimit me ujë të pijes në Komunën e Lipjanit,*
- *Informatë mbi shërbimet e ofruara të Kompanisë "Pastrimi".*

Lista e rregulloreve dhe planeve komunale të miratuar gjatë vitit 2016:

- *Rregullorja për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike*
- *Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit.*
- *Rregullore për taksat komunale*
- *Rregullore për plotësimin e rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi,*
- *Rregullore për Shërbimet Publike dhe Rendin Komunal,*
- *Rregullore për caktimin e tarifave për tatimin në pronë.*
- *Plani i punës së Kuvendit Komunal në Lipjan*

Lista e vendimeve komunale të miratuar gjatë vitit 2016:

- *Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2015*
- *Vendim mbi dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2014 dhe 2015 në vitin 2016.*
- *Vendim për miratimin e planit të veprimit për transparence në Komunë*
- *Vendim për miratimin e planit të veprimit kundër korrupsionit*
- *Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës në ZK Babush i Muhaxherëve*
- *Vendim për anulimin pjesërisht të vendimit 1nr.464-123 të dt.20.06.2006 dhe shkëputjen e kontratës 1-464-157 të dt.26.07.2006 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në ZK Konjuh (NTPSH. Sadovina).*
- *Vendim për anulimin pjesërisht të vendimit 1nr.464-123 të dt.20.06.2006 dhe shkëputjen e kontratës 1-464-159 të dt.26.07.2006 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në ZK Konjuh (NTP Adriatik Commerc)*
- *Vendim për miratimin e programit komunal trevjeçar për banim 2016-2019*
- *Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare*
- *Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme –lokaleve afarist të Komunës në ZK. Lipjan.*
- *Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK. Banullë.*
- *Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK. Ribar i Vogël*
- *Vendim për anulimin e pjesërisht të vendimit 1Nr. 464-123 dt. 20. 06. 2006 dhe shkëputjen e kontratës 1-464-164 te dt. 01. 08. 2006 për shfrytëzimin afatgjatë të pronës së paluajtshme*
- *Vendim për anulimin e vendimit 1Nr. 464-331 te dt. 23. 10. 2003 dhe shkëputjen e kontratës 1-463-322 te dt. 04. 10. 2007 për shfrytëzimin afatgjatë të pronës së paluajtshme*
- *Vendimi për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për bujqësi*
- *Vendimi për lirim nga pagesa e tarifave në institucionin për edukimin dhe arsimimin parashkollor publik në Lipjan të nënave vetë ushqyese për fëmijët e tyre.*



- *Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan*
- *Vendim për anulimin e aktvendimeve 1Nr.464-833 dt.21.10.2009, 1Nr.464-833/1 dt. 14. 04. 2010 dhe nënkontratave të datës 22. 10. 2009*
- *Vendim për zëvendësimin e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB-së*
- *Vendimi mbi dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitin 2015 në vitin 2016,*
- *Vendim për dhënien në shfrytëzim tokës pasurori shoqërore për vendosjen e trafo stacionit distributor në Lipjan,*
- *Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës së Sindikatës së Administratës Komunale.*
- *Vendim për caktimin e lokacionit për shkollën fillore e mesme e ulët “Emin Duraku” paralelja e ndarë fizike në Glllogoc.*
- *Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan*
- *Vendim për Korrnizën Afatmesme Buxhetore 2017-2019*
- *Vendim për Hapjen e Trasesë së Rrugës në Zonën Kadastrale Konjuh*
- *Vendim për miratimin e ofertës së “MABCO CONSTRUCTIONS”SHPK të përzgjedhur nga Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Lipjanit*
- *Vendim për miratimin e ofertës së “TROPIKANA AL MINING”SHPK të përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit*
- *Vendim për Themelimin e Zonës Ekonomike në ZK Qylagë*
- *Vendim për miratimin e nismës së Kuvendit të Komunës së Gjilanit për bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Lipjanit në fushën e infrastrukturës rrugore me interes të përbashkët*
- *Vendim për autorizimin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit për përfaqësimin e Komunës së Lipjanit për bashkëpunimin ndër komunal me Komunën e Gjilanit në fushën e infrastrukturës rrugore me interes të përbashkët.*
- *Vendim për miratimin e Planit të mobilitetit urban për Komunën e Lipjanit,*
- *Vendim për Miratimin e Strategjisë për Informim dhe marrëdhënie me Publikun e Komunës së Lipjanit,*
- *Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore e KK Lipjan, Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Baicë*
- *Vendim për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Komunës së Gjilanit dhe komunës së Lipjanit*
- *Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës- pasuri shoqërore për vendosjen e trafostacionit distributor në Lipjan..*
- *vendimi për aprovimin e buxhetit 2017-2019.*

- *Vendimi mbi miratimin e ri-destinimit dhe transferim të mjeteve buxhetore për vitin 2016.*
- *Vendim për shpalljen e Zonave me interes publik, zona kadastrave Lipjan dhe zona kadastrave Babushë i Muhaxhereve,*
- *Vendim për zëvendësimin e anëtarit KKSBB-së,*
- *Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare bashkësisë Islame në Lipjan.*

NOTIMI I PËRGHITHËM

Kuvendi i Komunës së Lipjanit numëron gjithsej 31 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 8 subjekte politike (LDK, PDK AAK-LDD-IQL, VETËVENDOSJE, AKR, PD, PSD dhe G.I.SRPSKA).

Vlerësimet janë të bazuara në vëzhgimin e drejtpërdrejtë dhe objektiv të punimeve të kuvendit komunal të Lipjanit Monitoruesit e YAHR-it kanë përcjellë të gjitha seancat e kuvendit të komunës së Lipjanit gjatë periudhës Korrik –Dhjetor 2016. Për më tepër, monitoruesit e YAHR-it kanë realizuar një numër të konsiderueshëm të takimeve individuale me shumë anëtarë. Anëtarët komunalë dhe subjektet politike janë notuar veç e veç në secilën nga nëntë kategoritë e poshtëshënuara si dhe mbi performancën dhe angazhimet e tyre në përgjithësi. Rezultatet e notimeve janë të shprehura në përqindje (%).



KATEGORITË

YAHR-i në këtë fletënotim ka pasqyruar dhe analizuar në mënyrë të përgjithshme performancën si dhe angazhimet e anëtarëve komunalë dhe subjekteve politike në kategoritë e paraqitura në vijim:

1. Propozim për rend dite
2. Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave
3. Pjesëmarrja në diskutime në emër të grupit të anëtarëve
4. Inicimi i çështjeve
5. Amandamentimi i legjislacionit
6. Inicimi i rregulloreve
7. Pyetjet parlamentare
8. Mungesa në seanca
9. Gjuha joparlamentare

Pjesëmarrja e delegateve të Kuvendit në diskutime nga seanca 31-35, në bazë të fletë-notimit për se cilin deputet:

- Vërejtje: përkatësia e politike e deputeteve është bazuar vetëm në bazë të certifikimit nga ana e KQZ-së dhe lëvizjet e bëra të deputeteve në mes subjekteve politike në këtë raport nuk janë marrë parasysh, se ka pasur lëvizje të shumta dhe nuk kemi qartësi të plotë të përkatësisë politike.

Tabela 3: Pjesëmarrja e Deputeteve gjatë seancave plenare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit


KOMUNA E LIPJANIT		Propozim për rend dite	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve	Inicimi i çështjeve	Amandamentimi i legjislacionit	Inicimi i rregulloreve	Pyetjet parlamentare	Mungesa në seanca	Gjuha jo parlamentare	Gjithsej pike
Deputetët	Subjekti politik										
PETRIT KELMENDI	PDK	0	8	0	0	0	0	0	-2	0	6
LULZIM RRUSTEMI	PDK	0	36	0	30	0	0	0	0	0	66
NAZMI KRASNIQI	PDK	0	16	0	10	0	0	0	0	0	26
ENVER KOZHANI	PDK	0	12	0	20	0	0	0	0	0	32
FERIZ HASANI	PDK	0	16	0	10	0	0	0	0	0	26
ALI STUBLLA	PDK	0	8	0	0	0	0	0	0	0	8
VALBONA SHILLOVA	PDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
BURBUQE ILAZI	PDK	0	8	0	0	0	0	0	0	0	8
VLORA BUJA	PDK	0	4	0	0	0	0	0	0	0	4
LABINOT SHAHINI	LDK	0	12	0	0	0	0	0	-1	0	11
NEHAT TERPEZA	LDK	0	16	0	0	0	0	0	0	0	16
DAUT AZEMI	LDK	0	20	0	5	0	0	0	0	0	25
AGRON HAJDINI	LDK	0	16	0	0	0	0	0	0	0	16
ARTON RETKOCERI	LDK	0	0	0	0	0	0	0	-1	0	-1
NAIM JAHIRI	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
VLORA LIMANI-HAJNUNI	LDK	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
BURBUQE FAZLIU	LDK	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1
LINDA SHAHINI	LDK	0	12	0	0	0	0	5	0	0	17
XHEVAT OLLURI	AAK-LDD-IQL	0	24	0	5	0	0	0	0	0	29
RIZAH BAJRAKTARI	AAK-LDD-IQL	0	4	0	0	0	0	0	0	0	4
UKË KRYEZIU	AAK-LDD-IQL	0	20	0	0	0	0	5	0	0	25
MERITA ZEQIRI-HAJRIZI	AAK-LDD-IQL	0	4	0	15	0	0	0	0	0	19
HAJRIJE SALIHU	AAK-LDD-IQL	0	16	0	15	0	0	5	0	0	36
ARBEN BAHTIRI	VETËVENDOSJE	0	12	0	15	0	0	0	0	0	27
EDITA GASHI	VETËVENDOSJE	0	12	0	0	0	0	0	0	0	12
BLERIM GASHI	AKR	0	44	0	15	0	0	0	0	0	59
ADELINA KRASNIQI	AKR	0	4	0	0	0	0	0	0	0	4
XHAVID MAHOLLI	PDK	0	0	0	5	0	0	0	-2	0	3
RAMIZ QIRIQI	PSD	0	36	0	35	0	0	20	0	0	91

ZORAN CIRKOVIC	G.I.SRPSKA	0	4	0	10	0	0	0	0	0	14
PETRIT KELMENDI	PDK	0	8	0	0	0	0	0	-2	0	6

TRENDI I DISKUTIMEVE

Gjatë periudhës Korrik –Dhjetor 2016, pjesëmarrja në diskutime e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Lipjanit në lidhje me pikat e rendit të ditës është karakterizuar me një rritje krahasuar me vitet tjera.

Deputetet më aktivë të kësaj periudhe kanë qenë udhëheqësit e grupeve të partive politike në Kuvend: RAMIZ QIRIQI PSD 91 pikë, FLORENT HOXHA PDK 78 pikë, LULZIM RRUSTEMI PDK 66 pikë, BLERIM GASHI AKR 59 pikë, HAJRIJE SALIHU AAK-LDD-IQL 36 pikë, ENVER KOZHANI PDK 32 pikë, XHEVAT OLLURI AAK-LDD-IQL 29 pikë, ARBEN BAHTIRI VETËVENDOSJE 27 pikë, NAZMI KRASNIQI PDK 26 pikë, FERIZ HASANI PDK 26 pikë, DAUT AZEMI LDK 25 pikë, UKË KRYEZIU AAK-LDD-IQL 25 pikë, MERITA ZEQRIRI-HAJRIZI AAK-LDD-IQL 19 pikë, LINDA SHAHINI LDK 17 pikë, NEHAT TERPEZA LDK 16 pikë, AGRON HAJDINI LDK 16, ZORAN CIRKOVIC G.I.SRPSKA 14 pikë, EDITA GASHI VETËVENDOSJE 12 pikë, LABINOT SHAHINI LDK 11 pikë, ALI STUBLLA PDK 8 pikë, BURBUQE ILAZI PDK 8 pikë, PETRIT KELMENDI PDK 6 pikë, VLORA BUJA PDK 4 pikë, RIZAH BAJRAKTARI AAK-LDD-IQL 4 pikë, ALBULENA GASHI/ADELINA KRASNIQI AKR 4 pikë, XHAVID MAHOLLI PDK pikë dhe BURBUQE FAZLIU LDK 1 pikë.



Deputete më pasivë të ashtuquajtur "Shikues" janë: VALBONA SHILLOVA PDK 0 pikë, NAIM JAHIRI LDK 0 pikë dhe ARTON RETKOCERI LDK -1 pikë.

Tabela 4: Renditja e deputeteve bazuar në angazhimet e tyre nëpër seanca plenare të Kuvendit të Lipjanit

Deputet aktivë dhe pasivë, me numrin e diskutimeve							
	Deputeti	Subjekti politikë	pikët		Deputeti	Subjekti politikë	pikët
1	RAMIZ QIRIQI	PSD	91	16	AGRON HAJDINI	LDK	16
2	FLORENT HOXHA	PDK	78	17	ZORAN CIRKOVIC	G.I.SRPSKA	14
3	LULZIM RRUSTEMI	PDK	66	18	EDITA GASHI	VETËVENDOSJE	12
4	BLERIM GASHI	AKR	59	19	LABINOT SHAHINI	LDK	11
5	HAJRIJE SALIHU	AAK-LDD-IQL	36	20	ALI STUBLLA	PDK	8

6	ENVER KOZHANI	PDK	32	21	BURBUQE ILAZI	PDK	8
7	XHEVAT OLLURI	AAK-LDD-IQL	29	22	PETRIT KELMENDI	PDK	6
8	ARBEN BAHTIRI	VETËVENDOSJE	27	23	VLORA BUJA	PDK	4
9	NAZMI KRASNIQI	PDK	26	24	RIZAH BAJRAKTARI	AAK-LDD-IQL	4
10	FERIZ HASANI	PDK	26	25	ALBULENA GASHI/ ADELINA KRASNIQI	AKR	4
11	DAUT AZEMI	LDK	25	26	XHAVID MAHOLLI	PDK	3
12	UKË KRYEZIU	AAK-LDD-IQL	25	27	BURBUQE FAZLIU	LDK	1
13	MERITA ZEQRIRI-HAJRIZI	AAK-LDD-IQL	19	28	VALBONA SHILLOVA	PDK	0
14	LINDA SHAHINI	LDK	17	29	NAIM JAHIRI	LDK	0
15	NEHAT TERPEZA	LDK	16	30	ARTON RETKOCERI	LDK	-1

Pjesëmarrja e subjekteve politike të Kuvendit në diskutime nga seanca 25-29, në bazë të fletë-notimit:

Tabela 5: Angazhimi i subjekteve politike gjatë seancave plenare të Kuvendit të Lipjanit

KOMUNA E LIPJANIT	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave			Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve			Inicimi i çështjeve			"Pyetjet parlamentare "			Mungesa në seanca		
Subjekti politik	Piket	%													
PDK	37	36.63	%	3	75	%	21	46.67	%	0	0.00	%	2	33.33	%
LDK	19	18.81	%	1	25	%	1	2.22	%	1	14.29	%	2	33.33	%
AAK-LDD-IQL	17	16.83	%	0	0	%	7	15.56	%	2	28.57	%	0	0	%
VV	6	5.94	%	0	0	%	3	6.67	%	0	0.00	%	0	0	%
AKR	12	11.88	%	0	0	%	3	6.67	%	0	0.00	%	0	0	%
PD	0	0.00	%	0	0	%	1	2.22	%	0	0.00	%	2	33.33	%
PSD	9	8.91	%	0	0	%	7	15.56	%	4	57.14	%	0	0	%
G.I.SRPSKA	1	0.99		0	0		2	4.44		0	0.00		0	0	

PYETJET E PARLAMENTARE DHE INICIMI I ÇËSHTJEVE

Është interesante gjatë kësaj periudhe raportuese kemi një dinamikë të mirë të ngritjes së shqetësimeve të qytetareve nga ana e deputeteve. Ku kemi 45 çështje të ngritura të problemeve të ndryshme që preokupohen qytetarët e Komunës së Lipjanit dhe krahasuar me vitin e kaluar kemi një rritje prej 200 %. Nga Subjektet politike me aktive është

Subjekti i PDK-së i cili gjatë kësaj periudhe i ka ngritur 21 çështje ose 46.67 % prej totali të përgjithshëm, pastaj është interesant krahasim me vitin e kaluar kemi një angazhim shumë aktiv të AAK-LDD-IQL me 7 çështje të ngritura ose 15.56 % dhe po ashtu PSD 1 me 7 çështje të ngritura ose 15.56 % , vazhdohet VV dhe AKR-në me nga 3 çështje të ngritura , G.I.SRPSKA me 2 ose me 4.44 % dhe LDK me PD me nga 1 çështje të ngritur me 2.22 %.

Sa i për ketë pyetje parlamentare të drejtuar mbi punën e ekzekutivit kemi Subjektin politik të PSD më aktiv, ku kemi 4 pyetje, pastaj edhe AAK-LDD-IQL me 2 pyetje.

Pyetjet dhe çështjet e ngritura nga mbledhja e 31-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 29.07.2016:


Florent Hoxha: Theksoi se 28 Korrik në Drenicë ka pasur të reshura të mëdha dhe sigurisht mund të ketë edhe dëme, që na nuk jemi të njoftuar. Andaj kërkoj nga drejtoritë përkatëse që të dalin në teren që të konstatojnë gjendjen lidhur me dëmet eventuale nga vërshimet dhe gjithashtu të kontrollojnë edhe ujin se a është i pijshëm a jo. Në vazhdim theksoi se në vitin 2013 Komuna e ka bërë regjistrimin e pronave publike, kurse tani Kryetari i Komunës ka formuar një komision për këtë çështje dhe se kjo është punë e dyfishtë. Në Banullë është duke u ndërtuar trotuari dhe rruga është ngushtuar dhe nuk i zen dy kerre, andaj është mirë që në njërin anë të bëhet zgjerimi i rrugës.

Enver Kozhani: Në rrugën “Hajredin Bajrami” në hyrje të qytetit nga perëndimi është mirë të vihet një shenjë për rrugën e cila është një krahëse meqë në atë rrugë njerëzit që nuk e din hyjnë në rrugën njëkahëse dhe paraqesin rrezik, gjithashtu në Magurë gjatë detonimeve të gurëthyesve ka dridhje të mëdha dhe kërkoj që organet kompetente të intervenojnë të këta gurëthyes dhe së paku të zvogëlohet sasia e eksplozivit.


Lulzim Rrustemi: është obligim i Kryetarit që të paraqet raport për gjendjen financiare e gjithashtu në Kuvend duhet të paraqitet edhe raporti i auditorit për vitin 2015. Pastaj tha se incizimi i mbledhjes së kaluar është paraqitë vetëm pjesa e parë.

Ramiz Qeriqi: Kërkoj që te fabrika e letrës të hiqet lënda djegëse, koks apo çka është meqë po kundërmon shumë dhe është kërkesë e lagjes të cilët kanë nënshkruar një peticion. Në shkollën në Krojmir më herët ka qenë mësimi shumë cilësor dhe nxënësit kanë nxënë vendin e 4-të në nivel të Komunës kurse tani aty nuk punohet dhe ka rënë suksesi dhe kjo shkollë është në vendin e fundit. Në vazhdim ngriti çështjen e lagjes pas ABE-së, se është hap tenderi për kanalizim dhe qytetarët kërkojnë që pjesa e kanalizimit e cila kalon nëpër oborre të shtëpive të dal në mes të rrugës.

Inicimi i çështjeve



Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve




Merita Zeqiri-Hajrizi: Kërkoj që në fshatin Bujari të mbyllet gropa septike e kanalizimit dhe të cilat kanë qenë gjer tani në shërbim për përcjelljen e ujërave të zeza kurse tani nuk janë të nevojshme dhe paraqesin rrezik edhe për njerëz edhe për kafshë. Pastaj kërkoj hapjen e kanaleve anësore të rrugës të cilat tani janë mbyllur nga disa qytetar dhe gjatë të reshurave ndodhin vërshime si që kanë ndodhur në vitin e kaluar. Në rrugën “Ramiz Shala” që lidhet me rrugën “Fehmi Jupa” gjatë qeverisjes së kaluar është asfaltuar vetëm gjysma e rrugës për shkak se kanë qenë disa pengesa pronësore, andaj kërkoj që kjo rrugë të asfaltohet.

Xhavit Maholli: Shprehi shqetësimin e qytetarëve të Gadimes, meqë Bektel Enka gjatë ndërtimit të autostradës ka mbyllë rrugët që qojnë në ara dhe për këtë duhet dikush të merr përgjegjësi.

Hajrije Salihu: Në hyrje të Lipjanit në rrugën që vije nga Banulla është një shtëpi që ka mbet si gërmadha e cila paraqet rrezik edhe për banor e gjithashtu i jep edhe një pamje të keqe, andaj organet kompetente duhet të marrin masa.

Pyetjet dhe çështjet e ngritura nga mbledhja e 32-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 05.09.2016:

Lulzim Rustemi: Ngriti disa çështje që ka të bëjë me fillimin e vitit të ri shkollor andaj kërkoj që në mbledhjen e ardhshme që të hynë për shqyrtim në Kuvend si raport apo si informatë. Çështje tjetër që ngriti ishte çështja e Lumit “Sitnica” dhe theksoi se nuk beson se është duke u zbatuar projekti detal i cili ka kushtuar 80 mijë euro dhe puna që po bëhet nuk ju ka përshtatë projektit detal dhe është duke u bërë vetëm pastrimi sikur i prockave andaj kërkoj që të informohemi për këtë. Çështje tjetër është rruga 4 kursi nuk e di që çka ka ndodh ku janë bërë hapja e disa shtigjeve pastaj mbyllja e tyre, heqja e skajorëve dhe përsëri vendosja e tyre dhe vendosja e dritave në parqe është i kualitetit shumë të dobët dhe për të gjitha këto kërkoj sqarime.



Ramiz Qeriqi: Pyeti Kryetarin rreth lagjes prapa ABE-së, ku banorët kanë bërë një peticion për rrugën që ka filluar me u ndërtuar dhe kërkoj përgjigje nga Kryetari për këtë. Në mbledhjen e kaluar kam kërkuar largimin e disa mbeturinave që janë grumbulluar nga disa kompani dhe ende nuk është bërë largimi i tyre. Në Krojmir ka rënë cilësia e mësimin se çdo herë kjo shkollë në kuadër të Komunës ka zënë vendin e katër për mësim kurse tash është e fundit. Pyetja e katërt ishte rreth fshatit Grackë të Vjetër ku është një kërkesë e qytetarëve shqiptarë, që nxënësit e tyre t'i vijojnë mësimet në shkollën Grackë të Vjetër meqë aty më herët është mbajtur mësimi edhe në gjuhën shqipe, kurse tani nuk është duke u mbajtur mësimi në gjuhën shqipe në këtë shkollë dhe kërkoj që në të ardhmen në këtë shkollë të mbahet mësimi edhe në gjuhën shqipe. Qytetarët e fshatit Krojmir kam bërë kërkesë për shtrimin e rrugës “Afërdita” dhe më ka premtuar Kryetari por kjo rrugë ende nuk është shtrua. Gjithashtu nga qytetarët e Krojmit është paraqit një kërkesë e nënshkruar nga qytetarët për pastrimin e Lumit Drenica në Krojmir.

Linda Shahini: Pyeti se çka është bërë me emërtimin e rrugëve meqë ka shumë kërkesa për ndryshimin e emërtimeve dhe e dyta kërkoj që në çdo hyrje apo shtëpi të vendoset një numër identifikues dhe e treta për rrugën Lipjan-Magurë e di që është mbyll tenderi dhe kur do të filloj ndërtimi i saj.

Arben Bahtiri: Ngriti çështjen tek rruga Lidhja e Prizrenit kupëzat që janë hjekë dhe janë duke u dëmtuar dhe kjo është shqetësuese. Mbjellja e drunjtëve dekorativ është duke u bërë shumë mirë por afër ambulancës këta drunjtë nuk kanë

pasur përkujdesjen e duhur dhe janë tharë, andaj kur bëhet një investim mbikëqyrja duhet të jetë më e madhe. Në rrugën e ambulancës janë duke u parkuar automjete dhe po pengojnë qarkullimin e njerëzve, andaj është mirë që të merren masa meqë ajo rrugë nuk është për parking të automjeteve. Problem tjetër është qenët endacak dhe tani jemi duke hyrë në sezonin e dimrit dhe për këtë çështje që tani të marrim masa.

Blerim Gashi: Pyeti Kryetarin se sa kohë më parë është prononcuar për objektin e stacionit të autobusëve dhe aty është punuar diçka dhe nuk e kemi të qartë se kur do të rivalizohet ky objekt apo në çfarë forme do të vendoset në shfrytëzim kur e dimë se ka qenë një kontest me AKP-në lidhur me borxhet. Çështje tjetër është rruga katër kursi ka mbetur në gjysmë dhe pyes se ku ka mbetur ky proces dhe a është në pyetje shpronësimi i pronave apo diçka tjetër.

Daut Azemi,: Këshilli i fshatit Babush ka bërë një kërkesë për rrënimin e objektit në Babush dhe nuk kemi marrë përgjigje. Rruga në hyrje për Babush është asfaltuar për kalim mbi autostradë dhe në këtë rrugë është ndaluar nga Bektel Enka qarkullimin e kamionëve me peshë mirëpo kjo nuk po respektohet dhe është mirë që Drejtori i Shërbimeve Publike apo Inspektorët të merren masa.

Enver Kozhani: mbledhjen e kaluar kam kërkuar nga Drejtoria për Shërbime Publike që në hyrje të Lipjanit të vendoset një shenjë për rrugën një kahesh mirëpo kjo ende nuk është vendos.

Zoran Çirkoviq: Para një viti kam kërkuar asfaltimin e rrugës te shkolla fillore “Vëllëzërit Aksiq “që është në gjatësi 70 deri 100 metra por gjerë më sot nuk është realizua kërkoj sqarim për këtë.

Në fshatin Grackë është kryer ndriçimi publik por tani shumë drita nuk punojnë dhe askush nuk është duke e mirëmbajtur ndriçimin.

Hajrije Salihu: Në mbledhjen e kaluar të Kuvendit kam shprehur shqetësimin tim për një shtëpi gërmadha në hyrje të qytetit nga ana lindore e cila shtëpi nuk mund të rinovohet dhe është rrezik për qytetarë, pyes a do të ndërmerret diçka për këtë.

Nazmi Krasniqi: Pyeti se a kanë filluar procedurat për emërtimin e shkollës në Glllogovc dhe Banullë.

Nehat Tërpeza: Në fshatin Ribar janë shtruar trotualet për gjatë rrugës ,mirëpo këto trotuare kalojnë edhe mbi urë dhe kërkoj vendosjen e mbrojtësve mbi urë nga Shërbimet Publike meqë është rrezik për qytetar.

Pyetjet dhe çështjet e ngritura nga mbledhja e 33-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 27. 09. 2016:

Xhevat Olluri: Pyeti lidhur me anulimin e vendimit në zonën kadastrave në Konjuh, vendimi në tërësi nuk është anuluar po ka filluar me anuluar në mënyrë të pjesshëm, pyetja është a janë anuluar të gjitha pjesët e asaj zone prej 20 hektarëve, cila pjesë ka mbetur edhe pse?

Florent Hoxha: I ngriti tri çështje: në rrugën “Arif Aliu” në Gadime të Ultë janë hap disa vrima nga ujësjellësi pse nuk janë riparuar dhe nuk janë kthyer në gjendjen e më hershme, po ashtu edhe në rrugën “Iliria” një vrimë ende nuk është riparuar, po ashtu te lagjja e “Lekiqëve” në Gadime të Ultë është dëmtuar rruga, si dhe është hiq tabela e tonotazhës. Kërkoj nga drejtoria përkatëse të sanoj. Po ashtu disa ditë më parë ka vdekur punëtori i Komunës Skender Gerbeshi së bashku me djalin, kërkoj nga Kryetari dhe Kuvendi ndarjen e shumës prej 5000 eruo pasi që ka lan të shoqen dhe djalin, që ka gjendje jo të mirë finaciare, po ashtu edhe një çështje te familja e Feim Neziri i cili ka vdekur nga sëmundja e kancerit i cili ka lër gruan dhe 4 fëmijë, i cili ma herët ka zhvilluar në biznes të vogël ne Lipjan në kuadër të këtij biznesi është gjellëtorja “Korabi” në Lipjan kërkoj nga komuna në baza ligjore të paktën dy vite të lirohet nga qiraja kjo familje.

Blerim Gashi: Vitin e kaluar kanë marr një zotim me ministrinë e infrastrukturës për tre rreth rrotullimet te kryqi Banullë-Dobratin ,kryqi Gadime,Llugaxhi, si dhe lagjja e re për Magurë dhe Shtime që kalon, si dhe rruga për në Aeroport, a do te fillojë sivjet?

Enver Kozhani: kërkesë e banorëve të fshatit Kraishtë dhe Ribar i Madh, ku është një kthesë e madhe dhe disa fidanë 3-4 metra lartësi dhe gjatësi 20 metra të cilat pengojnë, kërkoj nga drejtoria përkatëse të intervenoj mos të ketë aksidente me fatalitet?

Lulzim Rrustemi. Ka ngritur dy çështje e para ka të bëj nga mbledhja e kaluar për një çështje që e ngriti kryetari i komunës e që ka të bëj me “Eurokosi” dhe po e shfrytëzoj rastin që të nxjerri një arsyetim për atë çështje dhe e dyta çështje është për përdorimin e zyrave të administratës. E para në mandatin paraprak para vitit 2007 ku kryetar ka qenë ,profesori Xhevat dhe kryeshef ka qenë Kryetari i tanishëm dhe atëherë Komuna e Lipjanit ka dhënë në koncesion 3 prona, te “Dino”,para stacionit të policisë, të gjysmë rrethi “Adem Jashari “dhe te rruga për -ambulancë që tani atë pronë e ka “Eurokosi” që e ka marr me koncesion, në atë mandat “Eruokosi”.dhe për këtë unë nuk e di me cilat procedura dhe nuk e di se kuvendi i komunës ka një vendim që i ka marr pronën komunës dhe i ka dhënë “Besa Komercit” Pastaj tha se kryetari përmend takstativisht një vendim tjetër të vitit 2011 dhe unë e di mirë se ky vendim ka të bëj për përcaktimin e banesave për dhënien me qira dhe formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave. pastaj tha se para këtij vendimi kuvendi ka nxjerr rregullore për përcaktimin e kriterëve dhe kushteve për dhënien me qira të banesave të njerëzve që janë në nevojë. Në vitin 2008 në qershor komuna në bazë të kontratës të nënshkruar posedon 28% të pronës që “Eurokosi” e ka marrë me koncesion. Në këtë vendim shkruan se komuna posedon 20 banesa me sipërfaqe prej 1406.7 metra katrore kjo sipërfaqe është marr në bazë të një propozim vendimi që e ka propozua kryetari Shukri Buja dhe kuvendi është kryesisht në rregull me propozimin që ka ardhë. Pastaj tha se ky vendim ka hapë rrugën për shpalljen e konkursit për ndarje të banesave por konkursi nuk është shpallur asnjëherë dhe ato banesa nuk janë ndarë askujt dhe komuna e ka atë pronë aty. Ky është sqarimi im. Çështja e dytë është përdorimi i zyrave të administratës dhe se komitetet e kuvendit mbledhjet i mbajnë në sallën e bordit dhe unë si kryesues i komitetit për planifikim dhe urbanizëm mbledhjet e këtij komiteti me marrëveshje me anëtarët tjerë të komitetit i kam caktuar në ora 15:00 për shkak të shumicës së anëtarëve të komitetit që janë në punë. Në ditën që e kam pas këtë mbledhje asistentja e kryetarit tha se ne ora 16:00 unë e mbylli derën dhe nuk më intereson për mbledhje sepse nuk kam qen e njoftuar me herët, Unë mendoj se asistentja nuk mund ta caktoj orarin e mbajtjes së mbledhjeve dhe na nuk jemi të obliguar ta njoftojmë asistenten përveç që e njoftojmë administratën komunale dhe shërbimin e kuvendit.

Feriz Hasani: Një gjë që më shqetëson ka të bëjë me kompaninë “Mabetex” ku komuna ja ka dhënë një pronë për ndërtimin e një fabrike mirëpo ajo ka filluar ndërtimin e një muri mbi prrockën e lumit, mirëpo qytetarët janë të shqetësuar me këtë çështje dëshiroj ta di Komuna sa janë në dijeni lidhur me ndërtimin e atij muri.?

Ramiz Qiriqi: Ka ngritur disa çështje rreth procesverbalit i cili theksoi ose të bëhet mirë ose mos të bëhet hiq apo vetëm të shënohet diskutoj filani, Kur të votojmë është mirë të shënohen kush ka votuar kundër, edhe pse janë më pak kundër. E kam një vendim për heqjen e Koksit me vendim nga inspektoratit por në të nuk shkruan koha kur kanë me hjekur. Kam bërë dy kërkesa për drejtorin e Arsimit asnjëherë nuk kam marrë përgjigje edhe aty në procesverbal shkruhet se shkolla e Krojmirit është e katërta, unë kam thënë në mesin e katër shkollave, kamë than që është mirë edhe nxënësit Shqiptar edhe Serbë të mësojnë bashkë mos të bëhet ndarje nacionale ku në procesverbal është shkruar ndryshe.

Pyetjet dhe çështjet e ngritura nga mbledhja e 35-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 28. 10. 2016:

Hajrije Salihu: , Ngriti çështjen e një gruaje që e admiroj dhe ajo është gruaja e dr. Sami Bedrollit e cila disa herë ka kërkuar takim me Kryetarin dhe nuk ka mund të takohet e gjithashtu ka parashtruar kërkesë me shkrim për zgjidhjen e problemit të strehimit dhe më është lutë që çështjen e sajë ta paraqesë në Kuvend. Të gjithë e dijmë se bashkëshorti i sajë është mjek por është sëmurë në ish armatën Jugosllave dhe tani është në gjendje të vështirë dhe kërkojmë strehim.

Si çështje e dytë është çështja e shkollës “Adem Gllavica” ku xhamat janë thyer dhe është mirë që këta xhama së shpejti të rregullohen.

Ukë Kryeziu: Pyetje për Drejtorin e DRKS-së se a ka mundësi që të zgjatet orari i punës së Bibliotekës së Qytetit dhe atë deri në ora 19,00.

Florent Hoxha: Ngriti dy shqetësime: e para është shqetësimi i qytetarëve të fshatit Shalë dhe Kleçkë ku rruga e cila është shtrur nga Ministria e transportit Shalë-Kleçkë kanalet e saj janë mbyllur dhe kërkoj që mundësisht këto kanale të hapen në mënyrë që kjo rrugë mos të shkatërrohet. Shqetësim tjetër është i qytetarëve të Lipjanit për rrugën 4 korsi në Lipjan dhe pyesin se deri ku kanë shkuar punët dhe a është duke punuar sipas dinamikës së përcaktuar.

Ramiz Qeriqi: Pyetje për Kryetarin e Komunës dhe më vjen keq që nuk është këtu dhe unë në disa mbledhje më parë e kam ngritë çështjen e ujit që del te një ndërtesë dhe Kryetari më ka thënë se e kemi rregulluar këtë ujë por unë sot po e përsërisë se nuk është rregulluar fare. Për shkollën në Grackë kam bërë pyetje disa herë dhe nuk kam marrë përgjigje sikur kjo shkollë mos të ishte në Republikën e Kosovës. Te objekti i ri në gjimnaz është një kompani private e sigurisë dhe më intereson se a ka pasur tender për këtë dhe kush i paguan ata punëtorë na si prind apo Komuna.

Unë kam parë vetë aty se nxënësit kur kanë shkuar në eskurizion në Shqipëri para se të nisen kanë dalë me i thy paratë dhe kur janë kthyer me hy brenda roja nuk i ka lejuar. Për Drejtorin e shëndetësisë sigurisht se e dinë se në emergjencë çfarë automjete ka dhe shefi i emergjencës ka bërë një kërkesë por nuk dijë se a e ka marrë Kryetari. Për Lipjan është mirë që po punohet por drunjtë që janë mbjellë janë mbjellë shpesh a dhe unë e kam parë një grua me karroc që nuk mund të hynte në trotuar për shkak se drunjtë janë të mbjellë shpesh. Pastaj tha se më vjen mirë që sot në rend dite është informata për bujqësi dhe pyes Drejtorin pse ushtarit Osman Vuniqi nuk ju ka ndarë sera.

Për Krojmir ka shumë probleme dhe kanalizimi shpesh herë del mbi sipërfaqen e tokës, ndërsa në lagjen Meta, Olluri dhe Rizani rryma është shumë e dobët. Te gurthyesi që i është dhënë Eurokosit aty është formuar një gropë e madhe dhe ka pasur për obligim me e mbyllur por nuk e ka mbyllur e gjithashtu kur bëhet minimi puset e ujit turbullohen.

Enver Kozhani, tha se në qytet dhe fshatra është duke u rritur numri i qeneve endacak ku shumë prej tyre janë edhe të sëmurë dhe ekziston rreziku për ndonjë epidemi, andaj pyes se a është ndërmarrë diçka lidhur me këtë çështje.

Feriz Hasani, pyeti se sa kafshë kanë ngordhë në territorin e Komunës së Lipjanit nga sëmundja gungore dhe si është bërë varrosja e tyre.

Merita Zeqiri-Hajrizi: Ngriti shqetësimin e punëtorëve të punësuar në sektorin privat ku nuk zbatohet Ligji dhe shkelen të drejtat elementare të këtyre punëtorëve dhe lidhur me këtë pyes inspektorin se a ka bërë ndonjë kontrollë në kompanitë private.

Xhevat Olluri: Paraqiti shqetësimin për shkollat e mesme ku frekuentimi i automjeteve është e madhe dhe vozitet shpejt e gjithashtu edhe frekuentimin e nxënësve është tërë ditën dhe pyes Drejtorin e Shërbimeve Publike se a ka mundësi që para këtyre shkollave të vihen pengesa në rrugë në mënyrë që vozitësit të detyrohet të zvogëlojnë shpejtësinë.

AMANDAMENTIMI I LIGJISLACIONIT


Rreth amandamentimit të rregulloreve të ndryshme të kuvendit komunal gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka pasur .

MUNGESA NË SEANCA

Në Kuvendin e Komunës së Lipjanit është karakteristike se gjatë periudhës Korrik - Dhjetor 2016, kemi mungesa të deputeteve nëpër seanca. Ku nga radhët e PDK-së mungon në dy seanca deputeti Petrit Kelmendi ,pastaj Xhavit Maholli i Partisë së Drejtësisë po ashtu me dy seanca dhe nga një seancë mungojnë deputetet Labinot Shahin dhe Arton Retkoceri nga LDK-ja.

PROPOZIM PËR REND DITE

Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk kemi asnjë propozim konkretë nga ana e deputeteve për rendin e ditës.



Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Korrik - Dhjetor 2016,.
2. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, Korrik - Dhjetor 2016,.
3. Raportet mujore të drejtorive komunale të Komunës së Lipjanit, Korrik - Dhjetor 2016,.
4. Komunikatat për media të YAHR-it Korrik - Dhjetor 2016.
5. Ekstraktet nga mbledhjet e Kuvendit Komunal , Korrik - Dhjetor 2016,
6. <http://kk.rks-gov.net/lipjan/> .

